



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 81 Prot.

Tiranë, më 27/05/2024

UDHËZIME PËR PROCESIN ZGJEDHOR

**I/E NDERUAR ZGJEDHËS!
(Personel Akademik/Student)**

1. Votimet për autoritetet drejtuese të gjitha niveleve dhe Senatin Akademik në UBT zhvillohen në datën **21 Qershor 2024** e caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit për proceset zgjedhore të radhës.
2. Procesi i votimit pranë Qendrave të Votimit (KZF ose KQV) në çdo Fakultet fillon në orën **8:00** dhe mbyllet në orën **16:00 të ditës së zgjedhjeve**.
3. **Zgjedhësit qëndrojnë në radhe jashtë qendrave të votimit të njërive përkatëse dhe futen njëri mbas tjetrit për të votuar me thirrjen nga ana e një prej anëtarëve të komisionit.**
4. Zgjedhësi i radhës **identifikohet pranë Komisionit të Qendrës së Votimit (KZF ose KQV) me mjet identifikimi** (letërnjoftim/ pasaport/kartë studenti).
5. Zgjedhësi pas identifikimit **nënshkruan në listën e zgjedhësve** anash emrit të tij.
6. Zgjedhësi **tërheq pranë komisionit fletët e votimit** për kategoritë përkatëse të cilat duhet të jenë secila e vulosur në pjesën e pasme me vulën e KZF/KQV-së.
7. Zgjedhësi pasi merr fletët e votimit **shkon në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit në krah të emrit të kandidatit vendos shenjën „X“ / „+“ ose ndonjë shenjë tjetër të qartë që tregon zgjedhjen e bërë prej tij.**
8. Në rastin kur për autoritet drejtues konkurron vetëm një kandidat zgjedhësi voton një nga alternativat e shkruara krahas emrit të kandidatit "Pro" ose "Kundër".
9. Në fletën e votimit për anëtarë të Senatit Akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve shenjën "X"/"+"
- Zgjedhësi duhet të shënojë aq emra sa është numri i mandateve në Senatin Akademik që i përkasin njësisë kryesore përkatëse.**
10. Numri i shenjave që vendos në fletën e votimit është e udhëzuar në fletën e votimit.
KUJDES: Më parë se të ushtroni të drejtën e votës, shiko shënimet në fund të fletës së votimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

11. Pasi bën shënimin në fletën e votimit, i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.
12. Nuk lejohet plotësimi i fletëve të votimit jashtë dhomës së fshehtë.
13. Në rast se ndonjë fletë votimit dëmtohet ajo i kthehet komisionit dhe tërhiqet fletë tjetër votimi.
14. Në Qendrën e Votimit ndalohet kategorikisht përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit.
15. Në qendrën e votimit ndalohet qëndrimi i personave të tjerë me përjashtim të anëtareve dhe sekretarit të KZF/KQV/KIZ, votuesve të radhës, vëzhguesve të akredituar dhe përfaqësuesve të MASR.
16. Në mjediset e njëjësive kryesore, ku kryhet procesi i votimit ndalohet rreptësisht çdo lloj forme fushate zgjedhore për kandidatët konkurrentë.
17. Mbasorës 16:00 dhe mbylljes së Qendrës së Votimit, në të lejohet të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV/KIZ, vëzhguesit e akredituar, kandidatet dhe përfaqësuesit e MASR.

Kryetari i KIZ

Albert Kopali



Sekretari i KIZ

Edmond Kadu

